

KËRKESË
Nr. 1168, datë 29.6.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “ARTUR MEHMETI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitetet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2020 001187-5, datë 6.3.2020, për subjektin “Artur Mehmeti”, me NIPT: L61401017H, me adresë: Njësia Administrative nr. 5, rruga “Frano Bardhi”, pallati nr. 5, kati 1, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2020-001197-5

Datë 6.3.2020

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2020-001197-2, datë 6.3.2020, inspektim, që është zhvilluar në subjektin Artur Mehmeti, NIPT L61401017H, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Artur Mehmeti” ID: H60907069F, prej datës 6.3.2020 deri në datën 6.3.2020.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 6.3.2020 dhe e njoftoi në datën 6.3.2020.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektoratin sanitar shtetëror” (i ndryshuar); VKM nr. 379, datë 25.5.2016 “Për miratimin e rregullores ‘Cilësia e ujit të pijshëm’”, shtojca nr. VIII; neni 26, i ligjit nr. 7643, pika 14.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit *nuk* ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim i aktivitetit pa afat.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Nardi Kasmi ID_0401070007

Ermal ID_0401080010
Ibrahimi

Personi i autorizuar i subjektit:

Artur  IDH60907069F
Mehmeti



Refuzon

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Artur Mehmeti" ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

